



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë, 24.05.2012

Në pajtim me nenin 59 paragrafi 1, nenin 62 si dhe nenin 79 paragrafët 2 të ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Bordi i Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet me datë 13.07.2011, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

(KPMN NR. 02/2012)

Për Dënimet Administrative dhe Dënimet Mandatore

Neni 1

Personat juridik apo fizik që gjatë hulumtimit, shfrytëzimit apo përpunimit-pasurimit të lëndëve minerare-Leje për Aktivitete të Veçanta që veprojnë kundër **Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet** si edhe ligjeve të aplikueshme, do të dënohen sipas pikave të mëposhtme të këtij udhëzimi administrativ.

Dënimet Administrative

Nr.	Kodi	Përshkrimi	Shuma (€)
1.	DA001	Nëse personi juridik me aktivitetet kërkimore apo minerare pengon kompaninë tjetër pa marrëveshje paraprake në mes vete.	5,000.00 €
2.	DA002	Nëse personi juridik gjatë kërkimeve gjeologjike dëmton pronën pa pëlqimin e pronarit respektivisht të shfrytëzuesit të pronës.	10,000.00 €
3.	DA003	Nëse personi juridik që ka për detyrë ta dorëzojë një pasqyrë, raport apo ndonjë deklaratë, e dorëzon atë me të dhëna të pasakta.	5,000.00 €
4.	DA004	Nëse personi juridik largon ndonjë resurs mineral (në sasi më të madhe se sa është e lejuar) prej zonës së kërkimeve.	5,000.00 €
5.	DA005	Nëse personi juridik nuk i ruan dhe mirëmban në kushte të mira në Kosovë secilën mostër, të marrë në bazë të licencës, me të dhënat mbi datën, vendin dhe mos njoftimin e institucionit me adresën e vendndodhjes së mostrës metalike.	10,000.00 €

Nr.	Kodi	Përshkrimi	Shuma (€)
6.	DA006	Nëse personi juridik apo fizik pengon personin e autorizuar për kryerjen e punëve të tij në pajtim me ligjet në fuqi.	10,000.00 €
7.	DA007	Nëse personi juridik apo fizik nuk i zbaton në afatin e caktuar urdhëresat e personave të autorizuar.	1,000.00 €
8.	DA008	Në qoftë se personi juridik bën kërkimin e lëndëve të para minerale pa lejen e përcaktuar nga organi kompetent.	5,000.00 €
9.	DA009	Në qoftë se personi juridik nuk i aplikon masat e përcaktuara për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve, shtazëve dhe të pasurisë gjatë aktivitetit mineral.	2,500.00 €
10.	DA010	Në qoftë se personi juridik nuk e organizon shërbimin e mbrojtjes në punë.	5,000.00 €
11.	DA011	Në qoftë se personi juridik pas përfundimit ose ndërprerjes së përhershme të punëve kërkimore ose punëve të shfrytëzimit nuk ia dërgon raportin autoritetit licencues me dokumentacion përkatës.	5,000.00 €
12.	DA012	Në qoftë se personi juridik gjatë zhvillimit të punëve të minierave dhe të aktiviteteve të veçanta i shmanget projektit të lejuar, pa pëlqimin e mëparshëm të autoritetit licencues.	5,000.00 €
13.	DA013	Në qoftë se personi juridik pas ndërprerjes së përkohshme të punëve kërkimore ose shfrytëzuese, nuk i aplikon masat e duhura të sigurisë me të cilat do të përjashtohet mundësia e paraqitjes së rrezikut për njerëz, shtazë dhe pasuri.	5,000.00 €
14.	DA014	Në qoftë se personi juridik nuk e rehabiliton dhe rikultivon tokën e dëmtuar nga aktivitetet hulumtuese, përpunuese dhe minerare.	10,000.00 €
15.	DA015	Në qoftë se personi juridik nuk posedon me pajisjet e nevojshme të shpëtimit dhe nuk janë të atestuara.	5,000.00 €
16.	DA016	Në qoftë se personi juridik nuk e nxjerr rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen në punë.	5,000.00 €
17.	DA017	Në qoftë se personi juridik brenda afatit të përcaktuar nuk e njofton personin e autorizuar për çdo aksident fatal, lëndim të rëndë ose avari.	10,000.00 €
18.	DA018	Në qoftë se personi juridik nuk i lejon personat e autorizuar të hyjnë në lokalet punuese ose lokalet e reparit apo shikimin e raporteve të planeve dhe të dokumentacioneve tjera, ose pengon në kryerjen e funksionit të vet.	10,000.00 €

Nr.	Kodi	Përshkrimi	Shuma (€)
19.	DA019	Në qoftë se personi juridik nuk i zbaton masat për mbrojtjen e ambientit.	10,000.00 €
20.	DA020	Në qoftë se personi juridik i licencuar për përpunimin e materialit mineral, por që nuk posedon licencë të shfrytëzimit, nuk raporton çdo tre muaj, për prejardhjen dhe sasinë e materialit mineral.	5,000.00 €
21.	DA021	Në qoftë se personit juridik i verifikohet vëllimi i shfrytëzuar si pasojë e mos deklarimit të saktë.	5,000.00 €
22.	DA022	Në qoftë se personi juridik nuk mban shënimet financiare të sakta dhe sistematike lidhur me punët e tij në zonën e xehetarisë.	900.00 €
23.	DA023	Në qoftë se personi juridik nuk raporton dhe nuk i paguan me kohë obligimet për Rentë Minerare.	900.00 €
24.	DA024	Në qoftë se projektuesi gjatë hartimit të projektit ju shmanget qëllimisht aplikimit ose i ka aplikuar jo në rregull masat e përcaktuara të mbrojtjes në punë.	5,000.00 €
25.	DA025	Në qoftë se reviduesi i projektit nuk e ka bërë revidimin e projektit në bazë të rregullores për revidimin e dokumentacionit teknik dhe ka përdorur të dhëna manipuluese.	10,000.00 €
26.	DA026	Personi juridik gjobitet nëse punëtori i caktuar i cili përdor magazinën, depon, ose vend përgatitjen e vendit të prodhimit të mjeteve të eksplozivit në minierë apo sipërfaqe nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara të mbrojtjes në punë.	10,000.00 €
27.	DA027	Personi juridik gjobitet në qoftë se udhëheqësi përgjegjës dhe personi profesional në procesin teknologjik dhe në shërbimin e mbrojtjes në punë nuk bënë aplikimin dhe kontrollin e aplikimit të masave të mbrojtjes në punë që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga eksplozimet e rrezikshme të metanit, të gazrave tjera të rrezikshme, të eksplozivëve të ndryshme, të pluhurit, të qymyrit, ose të pluhurit agresivë të minierave, të depërtimit të ujit dhe zjarrit.	10,000.00 €

Neni 2

Dënimet Mandatorë

Nr.	Kodi	Përshkrimi	Shuma (€)
1.	DM001	Nëse personi juridik nuk e fillon punën brenda 3 muajve prej datës së lëshimit të licencës së hulumtimit, përveç nëse licenca parasheh ndryshe.	1,000.00 €
2.	DM002	Nëse personi juridik nuk e lajmëron personin e autorizuar për fillimin e punëve kërkimore dhe të shfrytëzimit 15 ditë para fillimit të punës.	500.00 €
3.	DM003	Nëse personi juridik nuk mban të dhëna të plota dhe të sakta në pajtim me kushtet e licencës dhe lejes.	1,000.00 €
4.	DM004	Nëse personi juridik nuk i ruan dhe mirëmban në kushte të mira në Kosovë secilën mostër, të marrë në bazë të licencës, me të dhënat mbi datën, vendin dhe mos njoftimin e institucionit me adresën e vendndodhjes së mostrës jometalike.	1,000.00 €
5.	DM005	Nëse personi juridik nuk i paraqet autoritetit licencues, për licencë të hulumtimit, brenda dy muaj pas përfundimit të vitit kalendarik raportin vjetor apo pasqyrat vjetore.	500.00 €
6.	DM006	Nëse personi juridik nuk i paraqet autoritetit licencues për licencë të shfrytëzimit, brenda 120 ditë pas përfundimit të vitit kalendarik raportin vjetor apo pasqyrat vjetore.	1,000.00 €
7.	DM007	Nëse personi juridik nuk i paraqet autoritetit licencues planin për kërkime, për vitin kalendarik vijues (jo më vonë se deri më 30 shtator të secilit vit kalendarik).	500.00 €
8.	DM008	Nëse personi juridik i pajisur me licencë për xehetari apo leje të posaçme, nuk i dorëzon autoritetit licencues raportet tremujore sipas kushteve të licencës dhe lejes.	1,000.00 €
9.	DM009	Nëse personi juridik nuk mban në një objekt brenda zonës së licencuar dokumentacionin teknik të kompletuar dhe të saktë për të gjitha punët e tij sipas licencës ose lejes.	1,000.00 €
10.	DM010	Nëse personi juridik nuk e informon me shkrim menjëherë autoritetin licencues për ndryshimin e skemës teknologjike (të pajisjeve) sipas lejes së posaçme.	1,000.00 €
11.	DM011	Nëse personi juridik nuk pajisë të punësuarin me pajisjet personale mbrojtëse të cilat janë paraparë për mbrojtje në punë.	1,000.00 €

Nr.	Kodi	Përshkrimi	Shuma (€)
12.	DM012	Nëse i punësuar nuk i përdor pajisjet personale mbrojtëse të cilat janë të parapara për mbrojtje në punë, atëherë kompania dënohet.	50.00 €
13.	DM013	Në qoftë se personi juridik nuk e mban librin e mbikëqyrjes të minierës dhe objekteve përpunuese.	1,000.00 €
14.	DM014	Në qoftë se personi juridik nuk e bën përshkrimin e vendeve të punës dhe kushtet e punës për çdo vend pune.	1,000.00 €
15.	DM015	Në qoftë se personi juridik, për punët kërkimore, të shfrytëzimit apo përpunimit-pasurimit të lëndëve të para minerale, cakton personat të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas përshkrimit të vendit të punës.	1,000.00 €
16.	DM016	Në qoftë se personi juridik nuk vepron sipas aktvendimit të organit kompetent.	1,000.00 €
17.	DM017	Në qoftë se i punësuar, në vend të punës, përdor alkool ose mjete narkotike, dënohet kompania	1,000.00 €
18.	DM018	Në qoftë se personi juridik nuk e ka të sinjalizuar fushën për të cilën posedon licencë.	1,000.00 €
19.	DM019	Në qoftë se personi juridik nuk e ka të stabilizuar rrjetin gjeodezik (minimum dy pika të stabilizuara brenda/afër minierës të njohura për nga pozita dhe lartësia).	500.00 €
20.	DM020	Në qoftë se personi juridik nuk mban ndaras librat e llogarive për punët e tij xehtarisë.	1,000.00 €


Neni 3

3.1 Të gjitha pikat e dënimeve administrative dhe dënimeve mandatore sipas këtij udhëzimi vlejné dhe për licencat e shfrytëzimit zejtar me të cilat pajisen Komunitat.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Me këtë Udhëzim Administrativ shfuqizohen dënimet Administrative dhe dënimet mandatore të cilat janë aplikuar deri më tani.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Ahmet Tmava

Ahmet Tmava
Kryesues i Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale